



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) bazuar në mandatin e sajë ligjor të përcaktuar me Ligjin Nr. 04/L-034 si dhe duke vepruar në pajtim me nenin 7 të Ligjit 04/L-061 Për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 01/12 janar 2012), shpallë:

NJOFTIM PUBLIK

PËR SHITJEN E BANESAVE PËR TË CILAT EKZISTON E DREJTA BANESORE

Njoftohen të gjithë bartësit e së drejtës banesore se me Ligjin 04/L-061 Për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, rregullohen kushtet dhe mënyra e shitjes së banesave në pronësi shoqërore dhe publike, për të cilat ekziston e drejta banesore apo e drejta e shfrytëzimit me qira për kohë të pacaktuar, së bashku me pjesët e përbashkëta dhe pajisjet e ndërtesës si dhe mënyra e përcaktimit të çmimit shitës të banesës dhe shuarja e së drejtës banesore.

AKP njofton bartësit e së drejtës banesore të cilët të drejtën e banimit (shfrytëzimit dhe/ose kontraktimit) e kanë fituar nga ndërmarrjet në pronësi shoqërore se, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë me shkrim për blerjen e banesës në afat prej dy 2 (dy) vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 04/L-061, Për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 01/12 janar 2012).

Bashkë me kërkesën për blerjen e banesës, secili parashtrues duhet të bashkëngjis (dorëzoj) dokumentacionin e nevojshëm në origjinal ose kopje të vërtetuar, me të cilin vërtetohet e drejta banesore.

Kërkesat e kompletuara dorëzohen drejtë për drejtë në Zyrën Qendrore të AKP-së ose përmes dërgimit postar në adresën: Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Njësia për Regjistrimin e kërkesave. Rruga "Ilir Konushevci" 8, 10.000, Prishtinë, Kosovë. Kërkesa për blerjen e banesës (formulari) mund të merret në secilën Zyre Rajonale të AKP-së ose nga faqja elektronike: www.pak-ks.org (Formulari: *Kërkesa për blerjen e banesës*).

Komisioni për çështje banesore është në dispozicion të gjithë qytetarëve dhe mund të kontaktohet çdo ditë në numrin kontaktues: 038 500 400 lokali 2044.